

2020

**KONTRATE SHËRBIMI  
PER GRUMBULLIMIN, TRANSPORTIN,  
DEPOZITIMIN DHE PERPUNIMIN E MBETJEVE  
TE NAFTAES (naftes se gropave, dherave te  
kontaminuara dhe te fundacioneve te depove, naftave te  
renda,etj)**

**MIDIS**

**PHOENIX PETROLEUM SH.A.**

**DHE**

**KESI SH.A.**

**Vendi i kryerjes së shërbimeve:**

- I. VENDBURIMI I NAFTAËS AMONICË**
- II. VENDBURIMI I NAFTAES PEKISHT**
- III. VENDBURIMI I NAFTAES FINIQ CRANE**

Tirane, me 01.01.2015

Kjo kontrate sherbimesh lidhet ndermjet:

Shoqerise **Phoenix Petroleum sh.a** me adrese: "Rruga e Elbasanit, Pallati i ri poshte Fakultetit Gjeologji-Miniera", Tirane e regjistruar prane QKR, me Nr. Nipti K92927401K, e cila do te quhet "**Kompania**" e perfaqesuar nga z. Naim Kasa, me cilesine e Administratorit te Kompanise.

**Dhe**

Shoqerise **Kesi sh.a** me adrese Lagjja 29 Nentori, Fier e regjistruar prane QKR me Nipt K22902401Q me numer licence LN-6190-02-2013, i cili ne vazhdim do te quhet "**Kontraktori**" e perfaqesuar nga z. Neshat Meli, me cilesine e Administratorit te Kompanise.

Secila nga te cilat mund te referohet individualisht si "Pale" ose "Palet"

Ndersa, **Kompania** deshiron qe **Kontraktori** te kryeje sherbimet e kerkuara sipas kerkesave te aktivitetit te saj ne vendburimin e Naftes Amonice, vendburimin e Naftes Pekisht, vendburimin e Naftes Finiq Crane, sipas Marrëveshjes Hidrokarbure "Per zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve ne vendburimin e Naftes Amonice; Pekisht; Finiq Crane"

**Dhe Kontraktori** bie dakort te kryeje te tilla sherbime ne perputhje me kushtet e rena dakort si me poshte vijon:

Adresa e Kompanise per sherbime njoftimi eshte:

Tel: ++355 4 2468473

Fax: ++355 4 2468477


e-mail: phoenixpetroleumgas@gmail.com

Cel: 0686043641

Adresa e Kontraktorit per sherbime njoftimi eshte:

Tel: ++ 355 (0) 342 21863

e-mail: companykesi@yahoo.com



Cel: 0692022305

## 1. Objekti i Kontrates

1.1 Objekt i kesaj kontrate do te jene kryerja e sherbimeve per "Grumbullimin, transportin, ruajtjen e depozitimin, perpunimin dhe asgjesimin e mbetjeve te naftes (naftes se gropave, dherave te kontaminuara dhe te fundacioneve te depove, naftave te renda, etj), sherbime keto te domosdoshme per kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure ne vendburimin e Naftes Amonice, Pekisht, Finiq Crane, bazuar Marreveshjes Hidrokarbure "Per zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve ne vendburimin e Naftes Amonice; Pekisht; Finiq Crane", sipas Aneksit I bashkangjitur kesaj kontrate.

## 2. Kohezgjatja e Kontrates

2.1 Palet kane rene dakort qe kjo kontrate do te hyje ne fuqi ne daten 01.01.2015, e vlefshme deri me 31.12.2020.

2.2 Palet kane rene dakort qe secila pale ka te drejte te nderprese kete kontrate duke i dhene pales tjeter njoftim me shkrim 15 dite kalendarike me pare.

## 3. Tarifat, Faturimi dhe Pagesa


3.1 Tarifat dhe faturimi i sherbimeve te punimeve objekt i kesaj kontrate do te behet sipas Aneksit I bashkangjitur.

## 4. Nenkontraktimi

4.1 Kontraktori nuk do te caktoje apo te nenkontraktoje nje Pale te trete per Sherbimet ose per ndonje pjese te Sherbimeve, pa marre me pare leje me shkrim nga Kompania.

## 5. Ligjet dhe Mosmarreveshjet

5.1 Nese ka mosmareveshje qe lindin gjate zbatimit te kesaj Kontrate qe nuk zgjidhen dot me marreveshje dypaleshe, ato fillimisht do t'i adresohen nje eksperti ose nje grupi



ekspertesh te miratuar dhe me pas do te adresohen per zgjidhje ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane.

5.2 Nëse një pjesë e kësaj kontrate do të bëhet e pavlefshme apo e pafuqishme nga ndonjë gjykatë apo një autoritet qeveritar i juridiksionit kompetent, atëherë kjo pjesë do të quhet e hequr dhe pjesa tjetër e kësaj kontrate do të mbetet në fuqi dhe do të jetë efektive.

5.3 Kjo kontratë është e gjithë marrëveshja e paleve dhe zëvendëson ndonjë komunikim të mëparshëm në lidhje me tekstin e kësaj marrëveshje, dhe nuk mund të nderrohet pa ndonjë amendament të nënshkruar nga përfaqësues të autorizuar nga dy palët.

## 6. Konfidencialiteti


6.1 Kontraktori duhet të trajtojë në mënyrë shumë konfidenciale të gjithë informacionin e marrë nga Kompania dhe, pa miratimin paraprak me shkrim nga Kompania nuk duhet të bëjë publik një informacion konfidencial tek një palë e tretë, ose ta perdore atë për qëllime që nuk parashikohen në këtë Kontratë.

6.2 Kontraktori nuk duhet të publikojë ose/dhe të lejojë publikimin e ndonjë informacioni, të shkruar ose gojor që ka të bëjë me Sherbimet, këtë kontratë dhe çdo gjë tjetër që lidhet me marrëdhëniet midis paleve pa miratimin paraprak nga Kompania.

6.3 Kontraktori pranon se çdo informacion, dokument, projekt, dhe çdo gjë tjetër e shkruar, kampione, programe kompjuteri ose pajisje të dhëna Kontraktorit nga Kompania për tu përdorur për realizimin e Sherbimeve mbeten prona e vetme dhe ekskluzive e Kompanisë. Kontraktori duhet t'i rikthejë kompanisë çdo informacion ose mall, pajisje etj. brenda 30 ditësh nga dita e përfundimit të shërbimit për të cilin ato janë përdorur, ose nga dita e ndërprerjes së Kontrates.

6.4 Kushtet e nenit 7 qëndrojnë në fuqi edhe pas ndërprerjes ose përfundimit të kësaj kontrate por nuk do të aplikohen për ndonjë informacion konfidencial që futet në sferën publike dhe që kërkohej me ligj që të bëhet publik.

6.5 Kjo kontratë shërbimesh në të gjithë përmbajtjen e saj është konfidenciale midis paleve nënshkruese.




## 7. Zhdentimi

- 7.1 Palet do te zhdemtojne dhe do te mbrojne njeri-tjetrin nga cfaredo pretendimi, humbje, kosto, shpenzime dhe deme per sa i perket humbje apo demtim te prones ose plagosje, semundje apo vdekje te ndonje personi te punesuar qe ka lidhje me kete kontrate cilido qofte shkak duke perfshire, por jo duke u kufizuar vetem ne neglizhencen e Kontraktorit ose Kompanise apo ne neglizhencen e te dy paleve njekohesisht.
- 7.2 Kontraktori do te njoftoje menjehere Kompanine per ndonje pretendim, kerkese apo veprim qe mund t'i paraqitet apo parashtrohet Kontraktorit nga ndonje pale per shkak te ndonje pune te kryer ne perputhje me kete kontrate.
- 7.3 Kontraktori do te mbroje Kompanine nga ndonje pretendim ne lidhje me garancite, taksat apo pengesa te tjera qe dalin nga shkelje te detyres nga Kontraktori ne lidhje me kete Kontrate.
- 7.4 Kontraktori do te mbroje Kompanine, do te jete pergjegjes dhe do te marre persiper detyrimet e tij ligjore (*nese ka*) per incidentet qe shkaktohen ose lidhen me permbushjen e Sherbimeve te cilat rezultojne ne humbje, demtim, plagosje, vdekje, ose demtim ambjenti dhe prone vuajtur nga nje pale e trete e cila nuk eshte anetare e Kompanise ose Kontraktorit.
- 7.5 Kontraktori bie dakort te zhdemtoje dhe te mbroje Kompanine nga cdo pretendim i nje pale te trete.

## 8. Forca Madhore

- 8.1 Asnje nga palet nuk do te jete pergjegjese ndaj tjetres per moskryerje te ndonje detyrimi te Kontrates se Sherbimit kur permbushja vonohet, pengohet apo ndalohet nga ndonje Force Madhore.



8.2 Do te konsiderohen Forca Madhore: zjarri, termeti, permbytje, apo çdo fatkeqesi tjeter natyrore, lufta, kryengritja e armatosur, gjendja e jashtezakonshme, terrori apo rrethana te tjera qe jane pertej kontrollit te arsyeshem te paleve.

8.3 Ndonje pale qe nuk eshte ne gjendje te permbushe pjeserisht apo totalisht detyrimet e Kontrates se Sherbimit do te beje menjehere nje njoftim me shkrim per palen tjeter duke deklaruar rrethanat ne detaje te bazuara duke theksuar keto Forca Madhore.

8.4 Nese nje pale pretendon per Force Madhore do te beje te gjitha perpjekjet e mundshme per ta menjanuar ate dhe do te njoftoje menjehere me shkrim palen tjeter per perfundimin apo nderprezjen e Forces Madhore.

8.5 Asnje Force Madhore nuk do te çliroje ndonjeren nga palet nga detyrimet e kesaj Kontrate Sherbimi pas perfundimit te Forces Madhore.

## 9. Gjuha dhe Korrespondenca

9.1 Korespondenca midis Paleve duhet te jete me shkrim dhe ne formen e postes se thjeshte, Fax ose poste elektronike, por ne cdo rast korespondenca do te protokollohet ne zyrën e kontratave ku do te mbahet edhe nje kopje.

9.2 Gjuha Shqipe dhe Angleze mund te perdoren ne korespondenca, por ne secilin rast dokumentat duhet te shoqerohen me perkthimet respektive.

9.3 Ne rast te ndonje mosmarreveshje, gjuha Shqipe do te jete gjuha kryesore ne kete kontrate.

Per dhe ne emer te KOMPANISE



Per dhe ne emer te KONTRAKTORIT

PHOENIX PETROLEUM SH.A.

KESI SH.A.

NAIM KASA

NESHAT MELI



**ANEKSI 1**  
**PERSHKRIMI I PUNIMEVE DHE TARIFAT**

**Pershkrimi i Sherbimit qe do te kryhet:**

Grumbullimin, transportin, ruajtjen e depozitimin, perpunimin dhe asgjesimin e mbetjeve te naftes (naftes se gropave, dherave te kontaminuara dhe te fundacioneve te depove, naftave te renda, etj)

**Palet ne kete kontrate kane rene dakort si me poshte:**

Kompania Phoenix Petroleum Sha nuk ka asnje detyrim financiar ne lidhje me sherbimin e siperpermendur qe **Kontraktori Kesi Sh.a** do te ofroje per kete qellim.

**Kontraktori** merr persiper dhe garanton sigurimin e plote te te gjitha burimeve financiare per realizimin e nje sherbimi te tille.

Per dhe ne emer te **KOMPANISE**

Per dhe ne emer te **KONTRAKTORIT**



**PHOENIX PETROLEUM SH.A.**


**KESI SH.A.**

**NAIM KASA**

**NESHAT MELI**

ADMINISTRATOR  
  


ADMINISTRATOR  
  




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Ministria e Ekonomisë,  
Tregtisë dhe Energjetikës

LICENCË



LN-6190-02-2013      NUJIS/NIPT: K22902401Q

Subjekti: KESI

Adresa: Fier, FIER, Fier, FIER, Lagjia "29 Nëntori", Rruga "Dervish Hekali",  
pranë Gjykatës së Shkallës së Parë

Kodi: III.2.B      Kod tjetër:

Data e lëshimit: 12/04/2013      Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetjeve të naftës (naftës së gropave; dherave të kontaminuara dhe të fondacioneve të depove; naftave të rënda me përmbajtje të lartë asfaltënesh dhe/ose rrëshirash), si dhe të vajrave të përdorura të automjeteve, të makinerive, grasove të ndryshme

Kufizime specifike:	Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi
Detyrime specifike	1. Gjehi bashkangjitur me Lejen kushtet për t'u zbatuar, për minimizimin e ndikimeve në mjedis. Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi
Vendi i kryerjes së veprimtarisë	Pranë Dekanimit Visokë, Pátos, Fier.

Kategoria	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale; lidhur me ndikimin në mjedis
Nënkategoria	
Veprimtaritë e tjera profesionale; lidhur me ndikimin në mjedis	
Veprimtari specifike	

Specialiteti



Nënshkrimi i sportelit: *Elbi Muzaj*



Pika 22

KONTRATE E NDRYSHUAR  
E KONTRATËS DATË 01 JANAR 2015 PËR GRUMBULLIMIN, TRANSPORTIN,  
DEPOZITIMIN DHE PERPUNIMIN E MBETJEVE TE NAFTES MIDIS "PHOENIX  
PETROLEUM" SHA DHE  
"KESI" SHA  
NE VENDBURIMIN E AMONICES, PEKISHTIT, FINIQ-KRANESE

Sot më date 01.09.2015, midis Palëve:

Shoqëri Phoenix Petroleum Sh.a me adrese Rr Elbasanit, Pallati i ri poshte Fakultetit Gjeologji-Miniera", Tirane e regjistruar prane QKR, me Nipt K92927401K, e cila do te quhet "Kompania" e perfaqesuar nga z. Naim Kasa, me cilesine e Administratorit te Kompanise.

Dhe

Shoqëri KESI sh.a me adrese Lagjia 29 Nentori, Rr. "Dervish Hekali", prane Gjykates se shkalles se pare, Fier e regjistruar prane QKR me Nipt K22902401Q, e cila ne vazhdim do te quhet "Kontraktori" e perfaqesuar nga z. Neshat Meli, me cilesine e Administratorit te Kompanise.

Secili më vete referuar si "Pala", dhe së bashku referuar si "Palët" bien dakord që:

Aneksi 1.

Aneksi 1, "Pershkrimi i Punimeve dhe Tarifave ", ndryshohet si më poshtë:



Neshat Meli

**ANEKSI I**  
**PERSHKRIMI I PUNIMEVE DHE CMIMET**

Palet ne kete kontrate bien dakord qe per kryerjen e sherbimit sipas objektit te kontrates te aplikojne keto tarifa

Nr	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Cmimi (USD)
1	Pastrim dhe transport i dherave te kontaminuara	M3	50
2	Evadim, transporti dhe injektimi ujrave te dala nga procesi i dekantimit ne puset e v/b Amonice	M3	8

- Ne cmimet e mesiperme nuk eshte perfshire TVSH-ja

Per dhe ne emer te KOMPANISE  
PHOENIX PETROLEUM SH.A.

NAIM KASA  
ADMINISTRATOR

Per dhe ne emer te KONTRAKTORIT  
KESI SH.A.

NESHAT MELI  
ADMINISTRATOR



*Neshat Meli*

